



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

REPublika e Kosovës - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
Oda e infirmierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo		
ARKIV ARHIV ARCHIVE		
Nr. Prot.	Nr. i faq.	Data:
Br. prot.	Br. str.	Datum:
Prot. no 830	No. page -12-	Date: 15.11.2022

Oda e infirmierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

Në mbështetje të Nenit 16 pika 2, 3 dhe 4 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe Nenit 19 të Statutit të Odës së Infirmierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësor të Kosovës, me propozim të Këshillit Drejtues, Kuvendi i Odës në mbledhjen e mbajtur me datën 15.11.2022, miraton këtë:

RREGULLORE

Për organizimin e zgjedhjeve, procedurën e kandidimit, të zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të Organeve të Odës së Infirmierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësor të Kosovës.

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen procedurat e organizimit të zgjedhjeve, procedurat e kandidimit dhe revokimit për anëtarë të Kuvendit, Kryetarit, Këshillit Drejtues, Këshillit Mbikëqyrës, Këshillit Etik, Gjyqin e Nderit, Prokurorit të Odës dhe të Komisioneve të përhershme të OIK-ut.

II. ORGANET PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE

Neni 2

Organet për zbatimin e zgjedhjeve për organet e Odës së Infirmierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësor të Kosovës janë:

1. Komisioni Qëndror zgjedhor (KQZ), i përbër nga 5 anëtarë të emruar nga Kuvendi i Odës.
Mandati i Komisionit Qëndror Zgjedhor zgjatë 4 vite.
2. Komisionet e njësisive zgjedhore të përbëra nga 3 anëtarë të propozuar nga njësia zgjedhore dhe të emëruar nga Komisioni Qëndror Zgjedhor.
Mandati i anëtareve të komisionit njësisë zgjedhor është 4 vite.
3. Sekretariati i Komisionit Qendror Zgjedhor për kryerjen e punëve profesionale dhe administrative emërohet nga Komisioni Qendror Zgjedhor.

Neni 3

Anëtarët e Organeve dhe trupat për organizimin dhe zbatimin e zgjedhjeve kanë për obligim që me përkushtim dhe devotshmëri të zbatojnë procedurat e parapara zgjedhore.

Çdo shmangie apo keqpërdorim është e sanksionuar me ligj dhe me akte normative të odës.

Neni 4

Anëtarët e Komisionit Qëndror Zgjedhor dhe zëvendësit, anëtarët e njësive zgjedhore dhe sekretariatit nuk kanë të drejtë kandidimi në organet e Odës.

Neni 5

OIK siguron mjetet e nevojshme për zbatimin e zgjedhjeve të destinuara për :

1. Kompenzimin e punës së KQZ-së, Komisionet e njësive komunale dhe sekretariatit të KQZ-së;
2. Shpenzimet e informimit publik;
3. Angazhimin e personave tjerë në procesin zgjedhor;
4. Shtypjen e materialit zgjedhor;
5. Sigurimin e materialit zgjedhor dhe materialeve të tjera shpenzuese;
6. Pajisjet e nevojshme teknike për zbatimin e zgjedhjeve dhe shpenzimet tjera materiale të rrugës, post telekomunikacionit etj.

III. PROCEDURAT E KANDIDIMIT DHE TE ZGJEDHJEVE TË ANËTARËVE TË ORGANEVE TË ODËS

Neni 6

Kuvendi i OIK-ut, me vendim për shpalljen e zgjedhjeve, përcakton datën e zgjedhjeve i cili duhet të jetë së paku 60 ditë para datës së skadimit të mandatit të përbërjes aktuale të Kuvendit.

Neni 7

KQZ në kordinim me komisionet e njësive zgjedhore dhe sekretarinë, ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për përgatitjen e zgjedhjeve për Kuvend, në pajtim me procedurat e parapara me këtë rregullore.

Neni 8

Kuvendi i Odës është organi me i lartë përfaqësues dhe rregullativ i Odës i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejt nga anëtarët e Odës në njësit zgjedhore të parapara me vendim të Komisionit Qëndror Zgjedhor.

1. Institucionet publike të nivelit parësor të kujdesit shëndetësor në çdo 75 anëtarë të regjistruar zgjedhin një (1) anëtarë, (duke siguruar përfaqësim të të gjitha njësive të nivelit parësor).

- Shërbimi i Qendrës së Mjekësisë Urgjente në Prishtinë është njësi e veçantë zgjedhore.
2. Institucionet publike të nivelit dytësor shëndetësor në çdo 60 anëtarë të regjistruar zgjedhin një (1) anëtarë për Kuvendin e OIK-ut.
 3. Institucionet publike të nivelit tretësor shëndetësor në çdo 60 anëtarë të regjistruar zgjedhin një (1) anëtarë për Kuvendin e OIK-ut. Të gjitha klinikat e QKUK-së janë njësi të veçanta zgjedhore. Njësitë zgjedhore në QKUK që kanë më pak së 20 anëtarë fuzionohen në mes vete deri në përmbushjen e kriterit.
 4. Në rast se kandidatët e zgjedhur në njësi përkatëse zgjedhore, kanë numër të njëjtë të votave, përparësi do të ketë kandidati i cili ka përvoj më të madhe profesionale.
 5. Institucionet Private Shëndetësore të cilët kanë të punësuar së paku 50 infermier, mami dhe profesionistë tjerë shëndetësorë në çdo 60 anëtarë të regjistruar të cilët kanë marrëdhënje të rregullt pune, zgjedhin një (1) anëtarë për Kuvendin e OIK-ut.
 6. Nga praktika private zgjedhen 30 anëtarë të regjistruar në Odë. Mënyra e zgjedhjes–delegimi i tyre do të vendoset nga Komisioni Qendror Zgjedhor.
 7. Institucionet e përkujdesjes sociale, institucionet për vuajtjen e dënimit, FSK, Policia, dhe institucionet tjera nga kjo kategori ku ofrohen shërbime klinike shëndetësore, të përcaktuar me vendim të KQZ-së delegojnë nga një (1) anëtarë
 8. KQZ me akt të veçant do të përcaktoj procedurat e kandidimit, votimit dhe vendvotimet për anëtarët e OIK të pa punësuar.

Neni 9

Me qëllim të formimit më të lehtë të njësive zgjedhore lejohet, shmangia nga kriteret e përcaktuara më lart për përcaktimin e numrit të anëtarëve që zgjedhë çdo njësi zgjedhore $\pm 10\%$.

I. PROCEDURAT E KANDIDIMIT

Neni 10

Për anëtarët e Kuvendit në OIK mund të propozohet, kandidohet dhe zgjedhet çdo anëtarë i OIK-ut, i regjistruar në regjistrin e anëtarëve të OIK-ut deri me datën e shpalljes së zgjedhjeve nga Kuvendi i OIK.

Neni 11

Secila kandidaturë për anëtarë të Kuvendit të OIK-ut duhet të mbështetet me nënshkrimin e së paku 5 anëtarëve të OIK-ut të secilës njësi zgjedhore.

Secili anëtarë mund të mbështes vetëm një (1) kandidaturë për anëtar të Odës të së njëjtës njësi zgjedhore, sekretaria e KQZ-së verifikon rregullsinë e kandidimit dhe në raste të mangësive i propozon anulimin e kandidaturës.

Neni 12

Pas përfundimit të procedurës së kandidimit, KQZ çertifikon kandidaturat për secilën njësi zgjedhore dhe publikon në faqën zyrtare të OIK-ut.

Kandidatët e pa kënaqur me rezultatet e çertifikimit të kandidaturave kanë të drejtë ankese në Gjyqin e Nderit në afat prej 48 orësh nga dita e çertifikimit final të kandidaturave.

Neni 13

Zgjedhjet për Kuvendin e OIK-ut mbahen në njësinë zgjedhore.

Secila njësi zgjedhore ka numrin e vet rendor të përcaktuar me vendim të KQZ-së.

KQZ-ja me vendim për çertifikimin e listave zgjedhore përcakton edhe numrin e anëtareve të Kuvendit nga secila njësi zgjedhore.

Renditja e kandidateve në njësinë zgjedhore bëhet sipas alfabetit.

Neni 14

KQZ-ja përmes sekretariatit obligohet që me kohë të përgatitë dhe distribuon materialin zgjedhor duke përfshirë fletëvotimet, ekstraktin e listës së votuesve, kutit e votimit, kabinat e votimit, procesverbalet dhe materialet tjera zgjedhore.

Materialet sensitive distribuohen jo më larg se 24 orë para ditës së zgjedhjeve, duke specifikuar secilin nga materiali zgjedhor dhe duke realizuar pranim-dorëzimin tek kryesuesi i komisionit të njësisë zgjedhore.

Neni 15

Votimi në njësi zgjedhore është personal dhe bëhet duke shenjësuar fletëvotimin në mënyrë të qartë emrin e kandidatit që votohet në njësinë zgjedhore.

Çdo votim i cili nuk qartëson saktësisht kandidatin e votuar dhe çdo fletëvotim me shenjësime të më shumë kandidateve se numri i kandidateve të përcaktuar nga KQZ konsiderohet fletëvotim i pavlefshëm.

Neni 16

Votimi në vendvotim fillon në ora 07:00 dhe përfundon në ora 19:00.

Në rast se të gjithë anëtarët e përcaktuar në listë votuese kanë votuar, komisioni i njësisë zgjedhore mund të mbyllë vendvotimin para orës 19:00.

Komisioni i njësisë zgjedhore ndërmerr të gjitha veprimet dhe përgatitjet për zgjedhje dhe gjatë tërë kohës së zgjedhjeve anëtarët e Komisionit të Njësisë Zgjedhore duhet të jenë prezent në vendvotim dhe të kujdesen për rregullsinë e zgjedhjeve në vendvotimin përkatës.

Neni 17

Secili votues në njësinë përkatëse zgjedhore duhet të identifikohet duke prezantuar kartelën e identifikimit apo çdo dokument tjetër identifikimi në bazë të së cilit qartë identifikohet votuesi i njësisë zgjedhore .

Neni 18

Në secilin vendvotim në ditën e zgjedhjeve mund të jenë prezent monitoruesit e çertifikuar nga KQZ-ja si dhe vëzhguesit e propozuar nga secili kandidat, paraprakisht të çertifikuar nga KQZ-ja.

Vërejtjet eventuale në procesin zgjedhor monitoruesit dhe vëzhguesit mund ti paraqesin gojarisht dhe me shkrim komisionit të njësisë zgjedhore.

Komisioni i njësisë zgjedhore në raste të cënimit të rendit dhe pengimit të zhvillimit normal të procesit zgjedhor mund ta largoj nga vendvotimi secilin monitorues dhe vëzhgues.

II. PËRCAKTIMI DHE SHPALLJA E REZULTATEVE TË VOTIMIT

Neni 19

Pas përfundimit dhe mbylljes së vendvotimit komisioni i njësisë zgjedhore përcakton rezultatet e zgjedhjeve në njësit përkatëse zgjedhore .

Paraprakisht në bazë të regjistrit të votuesve, përcakton numrin e përgjithshëm të votuesve që kanë votuar, në procesverbalin adekuat, pastaj bënë hapjen e kutive të fletëvotimeve, rezultatet i krahason me numrin e përdorur të fletëvotimeve dhe konstaton numrin e saktë të votuesve.

Pas përfundimit të numërimit të fletëvotimeve Komisioni i njësisë zgjedhore konstaton numrin e votave për secilin kandidat në bazë të renditjes në fletëvotim dhe të njëjtën liste e publikon në hapësirat e ambientit të komisionit të njësisë zgjedhore, më së largu 4 orë nga mbyllja e vendvotimit.

Neni 20

Komisioni i njësisë zgjedhore pas përfundimit të procesit zgjedhor dhe numërimit të të gjitha fletëvotimeve, plotëson formularin (e përcaktuar dhe distribuuar nga KQZ-ja) i cili do të përmbaj: numrin e tërësishëm të votuesve sipas regjistrit të secilës njësi zgjedhore, numrin e votuesve që kanë votuar, numrin e fletëvotimeve të pa përdorura, numrin e votave të fituara për secilin kandidat, numrin e fletëvotimeve të pa vlefshme.

Procesverbalet së bashku me dokumentet tjera zgjedhore duhet të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Komisionit të njësisë zgjedhore.

Neni 21

Procesverbalet së bashku me tërë materialin zgjedhor duhet të dorëzohen në Komisionin Qëndror Zgjedhor më së largu 12 orë nga përmbyllja e procesit zgjedhor në njësinë përkatëse zgjedhore.

Neni 22

Komisioni Qëndror Zgjedhor në afat prej 7 ditësh e çertifikon rezultatin final të zgjedhjeve për Kuvendin e OIK-ut sipas njësive zgjedhore.

Neni 23

Mandati i anëtarëve të Kuvendit të OIK-ut zgjat 4 vite dhe fillon të vihet nga dita e çertifikimit final nga Komisioni Qëndror Zgjedhor.

IV. PROCEDURA E ANKIMIMIT

Neni 24

Secili anëtarë i OIK-ut mund të ushtroj ankesë në rast se ka pasur pa rregullësi në procesin zgjedhor dhe i është cenuar ndonjë e drejtë konkrete ankimese.

Ankesa i parashtrohet në shkallën e parë komisionit të njësive zgjedhore në afat prej 12 orësh nga publikimi i rezultateve në vendvotim.

Komisioni i njësisë zgjedhore ka për obligim që në afat prej 12 orësh të shqyrtoj dhe kthej përgjigje ankimesit.

Kandidati i pa kënaqur me vendim të komisionit të njësisë zgjedhore mund të ushtroj ankesë KQZ-së në afat prej 12 orësh nga momenti i marrjes së vendimit të komisionit të njësisë zgjedhore.

KQZ-ja në afat prej 12 orësh vendos lidhur me ankesat e ushtruara ndaj vendimit të komisionit të njësive zgjedhore.

Kandidati i pa kënaqur ndaj vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor mund të ushtoj ankesë në afat prej 12 orësh Gjyqit të nderit të odës.

Gjyqi i nderit në afat prej 24 orësh vendos përfundimisht lidhur me ankesën e ushtruar ndaj vendimit të KQZ-së.

V. PROCEDURA E REVOKIMIT

Neni 25

Me kërkesën e mbi 50% të anëtarëve të Odës të njësisë përkatëse zgjedhore mund të filloj procedura e revokimit të kandidatit të zgjedhur në njësinë zgjedhore.

Iniciativa me shkrim i dorëzohet Komisionit të njësisë zgjedhore i cili e procedon te KQZ-ja.

KQZ-ja pas verifikimit të saktësisë dhe autentitetit të nënshkrimeve të anëtarëve të Odës nga njësia zgjedhore vendos për miratimin e kërkesës dhe shpalljen e zgjedhjeve për njësinë zgjedhore me se largu 45 ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Neni 26

Konsiderohet se anëtari i OIK-ut është shkarkuar në rast se për shkarkimin e tij votojnë mbi 50% e anëtarëve të njësisë zgjedhore .

Në rast të shkarkimit të anëtarit të Kuvendit nga njësia zgjedhore, KQZ-ja duhet të filloj procedurë për zgjedhjet plotësuese në njësinë përkatëse zgjedhore në afat prej 45 ditësh nga dita e votimit.

Neni 27

Anëtarëve të revokuar të njësisë përkatëse zgjedhore i'u pushon anëtarësimi në organet, komisionet dhe trupat tjerë të Odës së infermiereve, mamive dhe profesionisteve tjerë shëndetësor të Kosovës.

VI. ZGJEDHJA E KRYETARIT DHE ZV.KRYETARËVE TË ODËS

Neni 28

Kryetari i Odës zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejt dhe të fshehtë nga anëtarët e Kuvendit të Odës.

Neni 29

Secila kandidaturë për Kryetar të OIK-ut duhet të mbështetet me nënshkrimin e së paku 15 anëtarëve të Kuvendit të OIK-ut.

Secili anëtarë i Kuvendit mund të mbështesë vetëm një (1) kandidaturë.

Kandidatura në formë të shkruar (sipas formularit të përcaktuar nga KQZ-ja) i dorëzohet KQZ-së brenda afatit të paraparë me vendim të KQZ-së.

KQZ çertifikon listën finale të kandidatëve për kryetar të OIK-ut.

Kandidati për Kryetar duhet të dëshmoj se në katër (4) vitet e fundit nuk është marrë me ndonjë aktivitet politik.

Kandidati i pa kënaqur me vendimin e KQZ-së për çertifikim të rezultateve mund të ushtroj ankesë në afat prej 12 orësh nga dita e çertifikimit të kandidaturave në Gjyqin e nderit të odës. Gjyqi i nderit duhet të vendosë në afat prej 24 orësh nga moment i dorëzimit të ankesës së kandidatit të pa kënaqur me vendimin e KQZ-së.

Neni 30

Konsiderohet se është zgjedhur kandidati i cili ka fituar me së shumti vota me kusht që për të të votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve prezent.

Në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka fituar 50%+1 të votave të anëtarëve prezent, dy kandidatët me numër më të madhë të votave kualifikohen për rundin e dytë zgjedhor.

Në rundin e dytë të votimit konsiderohet se është zgjedhur kandidati që ka fituar shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit.

Neni 31

Me propozim të kryetarit të OIK-ut, Kuvendi i OIK-ut zgjedh dy (2) Zëvendës Kryetar të OIK-ut, nga radha e anëtarëve të Kuvendit.

VII. ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES

Neni 32

Më së largu 60 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit të OIK-ut bëhet zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Kryetari dhe Zëvendës kryetarët e OIK-ut janë anëtarë të Këshillit Drejtues sipas detyrës zyrtare.

Kandidatura e anëtarëve të Këshillit Drejtues duhet të mbështetet nga së paku 10 anëtarë të Kuvendit të Odës.

Votimi për anëtarët për Këshillin Drejtues është i drejtpërdrejt dhe i fshehtë.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues është 4 vite aq sa zgjatë mandati i anëtarëve të Kuvendit.

Anëtarët e zgjedhur dhe anëtarët e deleguar duhet të dëshmojnë se në katër (4) vitet e fundit nuk është marë me ndonjë aktivitet politik.

Anëtarët e deleguar nga Ministria e Shëndetësisë të jenë të profilit Infermier, Mami dhe Profesionistë tjerë Shëndetësorë, ku një përfaqësues të jetë nga Divizioni i Infermierisë me qëllim të koordinimit dhe avancimit të politikave në shëndetësi.

Këshilli Drejtues është në detyrë deri në konstitumin e Këshillit Drejtues të përbërbës së ardhëshme.

Neni 33

Zgjedhja e Kryetari dhe Zëvendës Kryetarit të Këshillit Drejtues bëhet nga radha e anëtarëve të zgjedhur nga delegatët e zgjedhur në Kuvend.

VIII. ZGJEDHJA E KËSHILLIT MBIKQYRËS

Neni 34

Më së largu 60 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit të OIK-ut bëhet zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

Kandidatura e Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës duhet të mbështetet nga së paku 10 anëtarë të Kuvendit të Odës.

Votimi për Kryetar dhe anëtarë për Këshillin Mbikëqyrës është i drejtpërdrejt dhe i fshehtë.

Mandati i Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është 4 vite aq sa zgjatë mandati i anëtarëve të Kuvendit.

Të drejtë kandidimi për Kryetar dhe Zëvendës kryetar të Këshillit Mbikëqyrës kanë vetëm anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi.

Anëtarët e deleguar nga Ministria e Shëndetësisë duhet të jenë të profilit Infermier, Mami dhe Profesionistë tjerë Shëndetësorë.

Këshilli Mbikëqyrës është në detyrë deri në konstitumin e Këshillit Mbikëqyrës të përbërjes së ardhshme.

Neni 35

Anëtarët e Kuvendit të Odës nuk mund të kandidojnë njëkohësisht në Këshillin Drejtues dhe në Këshillin Mbikëqyrës.

IX. ZGJEDHJA E KËSHILLIT ETIK

Neni 36

Më së largu 90 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit mbahen zgjedhjet për Kryetar dhe anëtarë të Këshillit Etik të Odës.

Kandidatura për Kryetar dhe anëtarë të Këshillit Etik duhet të mbështetet nga së paku 5 anëtarë të Kuvendit të Odës.

Të drejtë kandidimi për Kryetar dhe anëtarë kanë anëtarët e Kuvendit.

Votimi për Kryetar, Zëvendës kryetar dhe anëtarë për Këshillin Etik është i drejtpërdrejt dhe i fshehtë.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Etik është 4 vite aq sa zgjatë mandati i anëtarëve të Kuvendit.

Konsiderohet se janë të zgjedhur anëtarët që fitojnë më së shumti vota.

Anëtarët e deleguar nga Ministria e Shëndetësisë duhet të jenë të profilit Infermier, Mami dhe Profesionistë tjerë Shëndetësorë.

Këshilli Etik është në detyrë deri në konstitumin e Këshillit Etik të përbërjes së ardhshme.

X. ZGJEDHJA E GJYQIT TË NDERIT

Neni 37

Më së largu 90 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit, mbahen zgjedhjet për Gjyqin e Nderit të Odës

Kandidatura e Kryetarit dhe anëtarëve të Gjyqit të Nderit duhet të mbështetet nga së paku 5 anëtarë të Kuvendit të Odës.

Një anëtarë i Gjyqit të Nderit dhe Zëvendësi i tij delegohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Kryetari dhe Zëvendës kryetari i Gjyqit të Nderit zgjedhet nga anëtarët e zgjedhur të Gjyqit të Nderit por nga radha e anëtarëve të Kuvendit.

Mandati i Kryetarit dhe anëtarëve të Gjyqit të Nderit është 4 vite aq sa zgjatë mandati i anëtarëve të Kuvendit.

Konsiderohet se janë të zgjedhur anëtarët që fitojnë më së shumti vota.

Kryetari dhe Zëvendës Kryetari i Gjyqit të Nderit zgjedhet nga radha e anëtarëve të Gjyqit të Nderit që janë të zgjedhur nga Kuvendi.

Gjyqit i Nderit është në detyrë deri në konstitumin e Gjyqit të Nderit të përbërjes së ardhëshme.

XI. ZGJEDHJA E PROKURORIT DHE ZËVËNDËS PROKURORIT TË ODËS.

Neni 38

Me së largu 90 ditë nga dita e konstituimit të Kuvendit mbahen zgjedhjet për Prokuror të Odës.

Kandidatura për Prokuror duhet të mbështetet nga së paku 10 anëtarë të Kuvendit të Odës ndërsa për Zëvendës prokuror nga 5 anëtarë të Kuvendit të Odës.

Votimi për Prokuror është i drejtpërdrejt dhe i fshehtë.

Mandati i Prokurorit dhe Zëvendës prokurorit është 4 vite aq sa zgjatë mandati i anëtarëve të Kuvendit.

Konsiderohet se janë të zgjedhur anëtarët që fitojnë më së shumti vota.

Prokurori dhe Zëvendës prokurori është në detyrë deri në konstitumin e Prokurorit dhe Zëvendës prokurorit të përbërjes së ardhëshme.

XII. ZGJEDHJA E KOMISIONIEVE TË PËRHERSHME TË OIK-UT.

Neni 39

Komisionet e përhershme të Odës janë:

- Komisioni për Qështje Etike
- Komisioni për Licencim dhe Ri-licencim
- Komisioni për Edukim Specialistik
- Komisioni për EVP
- Komisioni i Solidaritetit dhe Ndihmës Reciproke
- Komisioni për Buxhet dhe Financa

Neni 40

Kuvendi i Odës me propozim të Këshillit Drejtues zgjedh kryetarin, zëvendës kryetarin dhe anëtarët e komisioneve të përhershme dhe të përkohshme nga radha e anëtarëve të Odës.

Neni 41

Fushëveprimi i Komisioneve të përhershme dhe të përkohshme përcaktohet me akte të veçanta normative të Kuvendit të Odës.

Neni 42

Kuvendi i Odës sipas nevojës mund të formojë edhe Komisione të përkohshme. Përbërja dhe fushëveprimi i komisioneve të përkohshme përcaktohet me vendim të veçantë nga Kuvendi.

Neni 43

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Odës.

Prishtinë
Datë: 15.11.2022



Kryetari i OIK-ut
z. Naser Rrustemaj

Naser Rrustemaj